



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES KONSTITUIVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 17 KORRIK, 18 SHTATOR
DHE 8 DHJETOR 2014**

**SA KONSTITUTIVNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 17. JULA, 18. SEPTEMBRA
I 08. DECEMBRA 2014. GODINE**

**KORRIK/SHTATOR/DHJETOR - JUL/SEPTEMBAR/DECEMBAR
2014**

Rendi i ditës

1. Formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve,
2. Dhënia e betimit të deputetëve,
3. Njoftimi për formimin e grupeve parlamentare,
4. Zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit.

Dnevni red

1. Formiranje ad-hok Komisije za verifikaciju kvoruma i mandata poslanika,
2. Polaganje zakletve poslanika,
3. Obaveštenje o formiranju parlamentarnih grupa,
4. Izbor Predsednika i potpredsednika Skupštine.

Mbledhjen e drejtoi deputetja e Kuvendit, znj. Flora Brovina.

KRYESUESJA: Të nderuar të zgjedhur të popullit në mandatin e pestë të Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar nga të gjitha partitë, pa marrë parasysh, ju uroj zgjedhjen! Ju dëshiroj që ta kemi një qetësi ndërmjet vete, një komunikim, dhe të punojmë me ndërgjegje, të cilën na e dha populli.

Kam kënaqësinë pra në emër të Legjislaturës së Pestë ta kryesoj këtë mbledhje konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, së bashku me deputeten më të re, Teuta Ibrahim Rugova, dhe e kam një kënaqësi të veçantë që ajo ndodhet këtu pranë meje.

Besoj që në këtë legjislacion ne do ta gjejmë mundësinë të dialogojmë mirë, të punojmë për vendin tonë, ashtu siç na e kanë dhënë votën votuesit.

Përhëndes në emër tuajin dhe timin presidenten e Republikës së Kosovës, zonjën Atifete Jahjaga,

Përhëndes përfaqësuesin e BE-së, zotin Samuel Zhibogar,

Përhëndes ambasadoren e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Trejsi Xhejkobson,

Ambasadorët e përfaqësuesit të zyrave diplomatike në Kosovës,

Përfaqësuesit e bashkësive fetare të Kosovës dhe të gjithë të ftuarit tjerë që marrin pjesë në këtë mbledhje konstituive, si dhe përfaqësuesit e shumtë të medieve.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në bazë të nenit 8 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit e ka përgatitur këtë seancë dhe e ka përcaktuar edhe rendin e ditës.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve

(Ndërhyrje)

Më fal, por nuk kemi debat. Kjo nuk është mbledhje e zakonshme, nëse vjen te një pikë e caktuar, atëherë ka mundësi. Pa diskutime!

Ju njoftoj, në bazë të neni 9, paragrafi 3 të Rregullores së Kuvendit, partitë politike të përfaqësuara në Kuvend duhet ta propozojnë nga një deputet për Komisionin e Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve.

Ky komision duhet ta shqyrtojë dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve, të mbajtura më 8 qershor 2014, për certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror Zgjedhor, dokumentacionin e regjistrimit të deputetëve dhe Kuvendit ia paraqet raportin

për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve në Kuvend, si dhe e verifikon kuorumin në mbledhjen konstituive të Legjislaturës së Pestë të Kuvendit.

Andaj, i ftoj përfaqësuesit e partive politike që t'i propozojnë emrat e deputetëve për anëtarë të këtij komisioni.

E ftoj përfaqësuesin e koalicionit PDK-PD-LB-PSHDK-PKK të propozojë.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit kryesuese!

Të nderuar kolegë,

Së pari dua të ju uroj të gjithëve për zgjedhjen si deputetë, përfaqësues të popullit! Uroj që vërtet ne të gjithë së bashku t'i përfaqësojmë dhe t'i mbrojmë interesat e qytetarit të Kosovës, ta arsyetojmë besimin tonë që na e kanë dhënë qytetarët e Kosovës, duke u angazhuar me përpikëri dhe maksimalisht t'i mbrojmë interesat e qytetarëve të Kosovës.

KRYESUESJA: Vetëm emrin e propozuar, më fal! Pa debat, të lutem!

ADEM GRABOVCI: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, si anëtar dhe kryetar të këtij komisioni e propozon Memli Krasniqin. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! E ftoj përfaqësuesin e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

VJOSA OSMANI: Kërkojmë në radhë të parë të evidentohet kundërshtimi ynë për shkeljen e vendimit të Kryesisë së Kuvendit që ka përcaktuar që Grupi Parlamentar LDK-AAK-Nisma të vendosen në ulëset e mesme...

KRYESUESJA: Më fal, pa debat, vetëm emrin!

VJOSA OSMANI: ...dhe kërkojmë që kjo parregullsi dhe kjo shkelje të rregullohet për seancat e ardhshme.

Në emër të Grupit Parlamentar LDK-AAK-Nisma, në fakt në këtë rast në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës si subjekt politik ne e propozojmë zotin Armend Zemaj për Komisionin Verifikues.

KRYESUESJA: Faleminderit! E ftoj Lëvizjen "Vetëvendosje".

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesuese!

Dua të them në fillim që këtu nuk po respektohet as në këtë konfiguracion të sallës vendimi i Kryesisë,...

KRYESUESJA: Pa diskutim, vetëm propozimi!

VISAR YMERI: ...dhe ju bëj ftesë edhe ju, zonja kryesuese, por edhe të gjithë deputetëve që ta respektojnë vendimin e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës që është nxjerrë para pesë ditësh për ulëset dhe për grupet parlamentare.

Nga Lëvizja “Vetëvendosje” në Komisionin për Verifikim do të jetë zonja Albulena Haxhiu.

KRYESUESJA: Faleminderit! Lista serbe?

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem predsedavajući!

Ja bih najpre da svima čestitam na novi izabranim kandidatima i da rad bude uspešan svih nas, i da radimo u interesu svih građana Kosova.

Predlog Poslaničke grupe Srpske liste za člana Komisije jeste Jelena Bontić.

KRYESUESJA: Kërkoj ndjesë, para Listës serbe është dashur ta thërras Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës. Më falni! Kërkoj falje!

VJOSA OSMANI: Zoti Armend Zemaj është përfaqësues i Grupit Parlamentar LDK-AAK-Nisma. Pra, ne do ta kemi një përfaqësues në këtë komision verifikues.

KRYESUESJA: Faleminderit! Atëherë Nisma për Kosovën?

Më falni, edhe një herë po e lexoj nenin 9.

Neni 9 i Rregullores së Kuvendit thotë: partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, duhet të...

Më fal, përfaqësuese e Lidhjes Demokratike, i ftoj partitë, subjektet politike që kanë fituar në zgjedhje ta përfaqësojnë nga një kandidat për Komisionin Verifikues. Kujtoj që shqip po më kuptoni?

Aleanca, a patët propozim apo jo? Nuk doni të keni propozim? Faleminderit!

DONIKA KADA-BUJUPI: Siç edhe e deklaruar, po e ritheksojmë edhe një herë që kandidati është i koalicionit LDK-AAK-Nisma zoti Armend Zemaj. Besoj që është e qartë kësaj here. Faleminderit!

KRYESUESJA: Nuk është e qartë, sepse unë po i ftoj partitë politike të përfaqësuara në Kuvend. Koalicionet nuk mund t'i ftoj, sepse nuk e kam kështu në Rregulloren e Punës.

Pa diskutime jashtë kësaj! E ftoj listën Nisma, a ka propozim? Shkojmë deri në fund dhe madje e marrim një vendim.

Partia KDTP, Partia turke?

MAHIR YAGCILAR: Sayın Cumhurbaşkanı, sizler milletvekilleri, öncelikle hepinizi seçim için tebrik ederim.

E shfrytëzoj rastin të ju uroj të gjithëve për zgjedhjen!

Komisyona Müferra Şinik hanımefendiyi öneriyorum. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! E ftoj koalicionin “Vakat”.

RASIM DEMIRI: Koristim priliku da čestitam svim novoizabranim poslanicima! Zelim uspešan rad! Ispred koalicije “Vakat” predlažemo gospođu Dudu Balje. Hvala!

KRYESUESJA: Faleminderit! E ftoj PDS-në.

NENAD RAŠIĆ: Poštovanje gospođo predsedavajuće,
Takođe ja želim svima kandidatima koji su dobili na izborima, dobili priliku da će oni predstavljati svoje zajednice, svoj narod, pa želim punu sreću na zajedničkom radu! Nadam se da ćemo održati kontinuitet dobro saradnje kao i do sad.

Ja predlažem da u ime jedne grupacije određene, koje smo od predstavnika zajednica napravili mi, jedan od kandidata bude na Listi za verifikaciju, u ovom slučaju mogla biti Emilija Redžepi. Prema tome, naša grupacija od 6 poslanika ima kandidata koji je za verifikaciju, odnosno gospođa Emilija Redžepi. Hvala!

KRYESUESJA: Në emër të partisë PDAK?

DANUSH ADEMI: Faleminderit!

Në emër të PDAK-së jam një deputet dhe mund ta propozoj vetëm veten, edhe pse jemi Grupi “6+”. S’kemi çka të diskutojmë, ngase kjo nuk është jashtë Rregullores.

KRYESUESJA: Ne si kryesuese e kësaj seance nuk e kemi bërë listën, por këto janë rezultatet zgjedhore dhe në bazë të rendit të ditës.

E ftoj subjektin NDS.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem predsedavajuća!

Svim poslanicima iz svih političkih subjekata i svih etnički zajednica želim puno sreće na današnjoj sednici! Nemate potrebe da sve pojedinačno pozivate, mi smo predložili jednog kandidata. Zahvaljujem!

KRYESUESJA: Po i përmbahem listës. E ftoj subjektin PLE.

VETON BERISHA: E nderuara kryesuese!

E nderuara zonja Presidente,

Më lejoni që në emër të Partisë Liberale Egjiptiane t’ju uroj për mandatin e ri. Meqenëse jam i vetmi deputet i kësaj partie, atëherë detyrimisht duhet të jem unë ai që do të jem në Komisionin Verifikues për Mandate. Edhe një here urime dhe suksese!

KRYESUESJA: Faleminderit! E ftoj përfaqësuesin nga subjekti politik PAI.

ETEM ARIFI: Faleminderit kryesuese!

Më lejoni që edhe në emrin tim t'ju uroj për mandatin e ri, për legjislacionin e pestë, kështu që jam i vetmi person, i vetmi deputet që e përfaqësoj këtë subjekt politik, atëherë do ta përfaqësoj vetveten, aty sigurisht.

KRYESUESJA: Faleminderit! Koalicioni për Gorën?

ADEM HODŽA: Poštovana predsedavajuća!

Poštovani predsedniče

Poštovani kolege, da iskoristim priliku da vam čestitam svim novoizabranim poslanicima i da poželim sretan rad! Ja sam Adem Hodža, i predstavljam Goransku zajednicu. S obzirom da sam sam, ja nemam tu predloga i ja sam u grupi Srpskoj, imamo tu predloga, Jelena Bontić. Hvala!

KRYESUESJA: E ftoj subjektin KNRP.

KUJTIM PAÇAKU: Të jeni shëndosh e mirë, e nderuara Presidente,

e nderuara kryesuese,

Të nderuar deputetë,

Ju përgëzoj dhe ju dëshiroj shëndet e punë të mbarë për sot! Meqenëse edhe unë jam i vetmi kandidat prej komunitetit rom, atëherë ngel ta propozoj veten.

KRYESUESJA: Faleminderit! Ju lus të gjithëve që me ngritje dore ta aprovojme Komisionin e Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve. Kush është për, kundër apo abstenim?

Sekretaria le t'i numërojë votat. Në sallë janë 120 deputetë. A ka kundër? Abstenime? Atëherë Komisioni është themeluar.

Konstatohet se Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit për Verifikimin e Mandateve të Deputetëve.

Tani e kemi një pauzë prej 15 minutash, e Komisioni mblidhet në sallën S-1.

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

KRYESUESJA: Vazhdojmë. E ftoj kryesuesin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Forumit dhe të Mandateve, zotin Memli Krasniqi, që ta paraqesë raportin.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, e nderuara kryesuese!

E nderuara zonja Presidente!

Më lejoni që në emër të Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve ta lexoj raportin për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve, i themeluar në mbledhjen e sotme konstituive të Legjislaturës së Pestë, më 17 korrik 2014, në pajtim me

nenin 9, paragrafi 4 i Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 17 korrik 2014, e shqyrtoi dokumentacionin zgjedhor, si në vijim:

Pika 1

Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, datë korrik 2014, për certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve, të mbajtura me 8 qershor 2014, dhe

Pika 2

Listën e deputetëve të regjistruar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit zgjedhor, me vetëm një votë kundër dhe një abstenim, konstatoi: Në Legjislaturën e Pestë të Kuvendit të Republikës të Kosovës janë certifikuar 120 deputetë nga subjektet politike, koalicionet dhe iniciativat qytetare që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e 8 qershorit 2014, si vijon:

Nën një:

- Koalicioni Partia Demokratike e Kosovës,
- Partia e Drejtësisë,
- Lëvizja për Bashkim,
- Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës,
- Partia Konservatore e Kosovës, gjithsej 37 deputetë.

Nën dy:

- Lidhja Demokratike e Kosovës, 30 deputetë
- Lëvizja “Vetëvendosje”, 16 deputetë,
- Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, 11 deputetë,
- Sërpska lista, 9 deputetë,
- Nisma për Kosovën, 6 deputetë,
- Kosova Demokratik Turk Partisi, 2 deputetë,
- Koalicioni “Vakat” 2 deputetë,
- Progresivna Demokratska Stranka, 1 deputet,
- Partia Demokratike e Ashkalinjve të Kosovës, 1 deputet,
- Nova Demokratska Stranka, 1 deputet,
- Partia Liberale Egjiptiane, 1 deputet,
- Partia e Ashkalinjve për Integrim, 1 deputet,
- Koalicija za Goru, 1 deputet,
- Kosovaki Nevi Romani Parti, 1 deputet.

Dhe, nën tre:

Komisioni gjithashtu konstatoi se në bazë të evidencës së deputetëve, në mbledhjen e sotme konstituive të Legjislaturës së Pestë, të pranishëm në sallën e seancave plenare janë 120 deputetë. Në bazë të këtyre konstatimeve, Komisioni i rekomandon Kuvendit që ta bëjë verifikimin e mandateve të deputetëve dhe t'i vazhdojë punimet sipas agjendës së paraparë dhe rregullave të procedurës

Prishtinë, më 17 korrik 2014 Ju faleminderit!

KRESUESJA: Faleminderit! Më fal, s' ka diskutim! I lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për raportin e Komisionit të Përkohshëm.

Nuk ka të drejtë, nuk kemi debat! Nuk është mbledhje e debateve. Kush është për raportin e Komisioni? A munde t'i numëroni votat? Dolën më lart, sepse...

Kush është kundër? A ka abstenime?

Konstatojmë se Kuvendi e miratoi...

Të lutem, Komisioni ka mundur ta sqarojë. Ju si përfaqësues i subjektit politik keni mundur ta sqaroni...

(Reagime nga salla)

Nuk kam mandat që në seancën solemne të zhvilloj debat. Nuk kemi mandat.

Edhe një herë konstatoj që me 44 vota për dhe të tjerët as për as kundër, nuk kryhet verifikimi.

Jua jap një pauzë dhe i ftoj përfaqësuesit e partive politike, kryetarët e partive politike në një takim në sallën 301.

KRYESUESJA: Jap pauzë dhe ftoj kryetarët e partive politike të vijnë në një konsultë. Seanca shtyhet deri në thirrjen time me shkrim të secilit deputet. Faleminderit!

Atëherë vazhdojmë, domethënë pas këtij shpjegimi edhe një herë verifikimi se sa veta jemi në sallë.

Numërimi i deputetëve. Konstatoj se në sallë janë 120 deputetë. Tani votojmë, sepse ndoshta nuk janë numëruar.

Sa janë për raportin, me ngritje dore? Numërimi i votave. Ju lutem, duart më lart! Faleminderit!

A ka kundër? Konstatoj se nuk ka. A ka abstenim? Konstatojmë që nuk ka.

Pra raporti i Komisionit miratohet me 117 vota për. Dhe, me këtë e përfundojmë këtë pikë të rendit të ditës.

Tani është pika më solemne e rendit të ditës:

2. Dhënia e betimit të deputetëve

Ju njoftoj se betimi solemn i deputetëve është një veprim i paraparë me Kushtetutën dhe rregulloren e Kuvendit. Tekstin e deklaratës së betimit e ka secili deputet para vetes dhe i njëjti duhet të nënshkruhet personalisht, pastaj të dorëzohet te Sekretaria.

Për ta përmbushur këtë detyrë, lus deputetët që të ngrihen në këmbë dhe ta dëgjojnë tekstin që do ta lexoj unë dhe, vetëm në fund, të gjithë së bashku e shqiptojmë fjalën ‘betohem’, secili në gjuhën e vet.

Unë, deputet i Kuvendit të Kosovës, betohem se me nder dhe me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interesin e Kosovës e të gjithë qytetarëve të saj. Do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe integritetin institucional të Kosovës. Për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane. BETOHEM! Faleminderit!

Edhe një herë i lus deputetët që deklaratën ta nënshkruajnë dhe Sekretaria i mbledh.

3. Njoftimi për formimin e grupeve parlamentare

Kalojmë në pikën tjetër, por pika e 3-të e rendit të ditës konstatoj që nuk është kompetencë e kryesimit tim formal, sepse unë dhe zonjusha Teuta Ibrahim Rugova jemi formalisht, vetëm falë moshës që e kemi sot, e kryesojmë këtë seancë. Ne nuk kemi kompetenca më shumë. Kjo pikë e renditur duhet të kalojë në kompetencë pas pikës 4, ose i kalon kryetarit të ri: Formimi i grupeve parlamentare. Kjo vlen edhe për grupin parlamentar të minoriteteve, që e dorëzuan tash një material.

4. Zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit

Në bazë të nenit 67, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar, andaj në pajtim me nenin 67, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 12, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, nga deklaratimet e deritanishme, grupi parlamentar më i madh i deklaruar është Grupi Parlamentar i LDK-së...

Më falni! Ky është konstatim, domethënë e hapim këtë dhe i ftoj sipas renditjes, siç u tha nga Komisioni Verifikues, dhe i ftoj partitë dhe subjektet që të propozojnë.

(Reagime nga salla)

Po, po, ta jap fjalën. Secila parti veç e veç, a bën sipas renditjes? T’ju them të drejtën, nuk kam kompetenca që ta kryej. Sipas skenarit... unë s’jam kryetare e Parlamentit dhe...

(Reagime nga salla - kërkesë për pauzë.)

KRYESUESJA: Mund ta keni, vetëm edhe një kërkesë është nga Partia Demokratike. Pasi e more ti fjalën, po ia jap edhe këtij, por tash kemi disa konsultime.

HAJREDIN KUÇI: E nderuara kryesuese e Kuvendit,

Të nderuar deputetë të Legjislaturës së Pestë,

Më lejoni fillimisht t'ju uroj punën për këtë legjislaturë dhe dua të them se ne sot jemi para një sfide në ndërtimin e institucioneve të reja. Natyrisht, Legjislatura e Pestë nënkupton që kemi edhe një përvojë demokratike, kemi një përgjegjësi institucionale para qytetarëve të Republikës së Kosovës, por edhe para partnerëve tanë ndërkombëtarë.

Më lejoni që të them se sa herë që kemi ndërtuar institucione, jemi sfiduar në momentet e caktuara dhe pastaj ka ndodhur që të sfidohemi edhe në kuptimin legal. Sot e kemi një dilemë, dilema në legjitimitetin demokratik dhe në legalitetin dhe më lejoni të them që në këtë drejtim Partia Demokratike e Kosovës mendon që konflikti ose kontesti lind kur të dyja palët mendojnë që kanë të drejtë dhe kësaj radhe të dyja palët po mendojmë që kemi të drejtë, por ne kemi ndërtuar institucione që na tregojnë se cila palë ka të drejtë.

Paraprakisht po e them që ne jemi për zgjidhje. Vjosa, durim pak të lutem! Paraprakisht po ju them që Partia Demokratike insiston ose kërkon nga partitë politike në Kuvend që gjithmonë ta kemi një konsensus për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese dhe ne do ta respektojmë cilindo veprim. Nëse një konsensus i tillë nuk bëhet dhe unë e di shumë mirë që mentaliteti që krijon probleme, nga ai mentalitet nuk i zgjidh, duhet një mentalitet tjetër, atëherë mendoj se Qeveria e Kosovës t'ju njoftoj publikisht do ta dërgojë sot çështjen në Gjykatën Kushtetuese dhe pastaj kjo çështje do të zgjidhet dhe ne do ta respektojmë në plotësi.

Faleminderit për durimin, për ata që e patën!

KRYESUESJA: Urdhëro, Vjosa!

VJOSA OSMANI: Në radhë të parë, ju sapo si kryesuese dhe si deputete e dhatë një betim që ta respektoni kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë në vend. Ne, prandaj kërkojmë që në përputhje me nenin 67 të Kushtetutës, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit dhe në përputhje me skenarin i cili është përgatitur për ju ta lexoni në seancën e sotme, t'ia jepni fjalën grupit më të madh parlamentar LDK-AAK-Nisma, që përbëhet nga 47 deputetë dhe, siç e dini, nuk është evidentuar asnjë grupi tjetër më i madh që sot ta propozojë kandidatin për kryetar të Kuvendit. Në qoftë se na jepni fjalën, unë do ta bëj propozimin menjëherë.

Në rregull! Meqenëse edhe ju më herët thatë që grupi më i madh është LDK-AAK-Nisma dhe ajo është evidentuar në transkript, unë propozoj që zoti Isa Mustafa, si kandidat yni, të votohet për kryetar të Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Kjo Kryesi nuk ka kompetenca për miratimin e grupeve të reja parlamentare. Kjo mbështetet në raportin e Komisionit Verifikues. Konkretisht,

propozimi i Partisë Demokratike ose i Qeverisë, unë nuk e di në emër të kujt fole, ishte që çështja të shkojë në Kushtetuese.

(Reagime)

Për shkak të problemit të krijuar dhe thjesht të menaxhimit të seancës, më tutje e jap një pauzë se nuk mund të procedoj më tutje. Jo, nuk mund ta qesim s'ka çka. Faleminderit! Deri te thirrja tjetër, ju lus...!

Pra, më duhet të këshillohem. Sot nuk e mbylлим, por po japim pauzë.

(Reagime)

Ka propozime për debat, por debat këtu nuk ka! Ka propozime dhe po më duhet. As unë nuk kam ardhur për qejf, atëherë ju lus të mirëkuptohemi se po na duhet, ndoshta që të dyjave konsultim juridik, prandaj e bëjmë një pauzë deri në orën 13:00.

(Reagime)

KRYESUESJA: Nuk e kemi filluar pikën e katërt!

(Reagime)

Mua po më nevojitet vetëm të merrem vesh me përfaqësuesit e partive për konsultim.

(Reagime)

KRYESUESJA: Lus që të kthehen të gjithë në vendet e veta, në sallë! Ftoj deputetët e Partisë Demokratike t'i zënë vendet e veta. Pauza mbaroi.

(Reagime)

Vazhdojmë me rendin e ditës:

4. Zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit

E ftoj sekretarinë që ta konstatojë kuorumin në sallë. Vazhdojmë! Sa janë të pranishëm?

Të pranishëm janë 113 deputetë. Kuorum ka. Atëherë vazhdojmë me pikën e katërt. E ftoj përfaqësuesin e partisë...

(Reagime nga salla)

Nuk kam renditje, mos e komplikoni. Ftoj përfaqësuesin e koalicionit të PDK-së dhe partitë tjera që ta paraqesin propozimin e vet...

(Reagime)

...pastaj e shohim, nëse keni diçka. Kur ta merrni fjalën, flisni!

ADEM GRABOVCI: Kam kënaqësinë e veçantë që në emër të Partisë Demokratike të Kosovës dhe të koalicionit zgjedhor ta propozoj për kryetar të Kuvendit Agim Aliun, njeriu i cili besoj që përfaqëson dhe i plotëson të gjitha kriteret. Faleminderit!

KRYESUESJA: E ftoj përfaqësuesin e Lidhjes Demokratike që ta paraqesë kandidaturën për kryetar të Parlamentit.

VJOSA OSMANI: Në radhë të parë, ju po bëni shkelje, duke mos dhënë në votim mocionin e 50 deputetëve për zëvendësimin e kryesueses, e cila refuzoi udhëheqjen e seancës. Së dyti, kërkoj nga ju që ta respektoni skenarin, Kushtetutën dhe Rregulloren dhe fjalën t'ia jepni Grupit Parlamentar LDK-AAK-Nisma, të parit për propozim.

E treta, kërkoj që të evidentohet edhe një herë që propozimi i Grupit parlamentar LDK-AAK-Nisma për kryetar të Kuvendit është Isa Mustafa dhe i ftoj deputetët që ta votojnë.

KRYESUESJA: E ftoj Lëvizjen “Vetëvendosje” që ta propozojë kryetarin nga subjekti i vet.

(Reagime)

Pritni, po thoni vazhdim, e nuk po më lejoni të flas!

E ftoj Lëvizjen “Vetëvendosje” që ta paraqesë propozimin për kryetar. Nuk keni propozim.

Për kandidatin e propozuar nga partia që i ka fituar votat, e që thuhet me ligj se e propozon kandidatin e parë, kush është për? Kur flisni të gjithë, kemi vështirësi të merremi vesh. Kush ishte kandidat, se nuk e dëgjova askund?

Agim Aliu është kandidat i Grupit Parlamentar të PDK-së për kryetar të Kuvendit. Votojmë tash!

Diskutim pa mikrofon të kyçur, i dorëzuar me shkrim.

VJOSA OSMANI: “Ne kërkojmë një pauzë të shkurtër, në mënyrë që të ketë konsultim rreth kësaj pike ndërmjet kryesueses dhe grupeve parlamentare. Kërkoj që të mbahet procesverbal mekanik dhe të përfshihet kjo kërkesë në transkript, meqë nuk po më lejohej të flas në mikrofon. Është obligim i Administratës të mbajë procesverbal mekanik në këto raste. Prandaj, kërkoj që kjo të bëhet. Ne kërkojmë pauzë dhe do të dalim në pauzë për konsultim”.

(Vjosa Osmani, d. v.)

(Reagime)

KRYESUESJA: Tani ishim në procesin e votimit, ju po dilni dhe s'kam çfarë të bëj! E lus Sekretarinë ta vërtetojë se sa janë të pranishëm. Faleminderit! Nga 120 deputetë, 47 janë të pranishëm. Nuk ka kuorum, prandaj seancën e vazhdojmë pasi të merremi vesh. Ju lajmërojmë me shkrim. Faleminderit!

Për shkak të procesverbalit, për sot seanca merr fund. Ju lajmëroj për vazhdimin e seancës me shkrim të gjithëve.

(Drejtimin e mbledhjes e merr ndihmës-kryesuesja, deputetja Teuta Rugova.)

KRYESUESJA: E vazhdojmë seancën konstituive të Kuvendit. Së pari kërkoj të dhënat për kuorumin nga Sekretariati.

Në sallë i kemi 81 deputetë. Me mocionin që ju është shpërndarë për zëvendësim të udhëheqjes së kryesueses së Kuvendit, ju kisha lutur që me ngritje të dorës të votojmë për kush është për, kundër, abstenim? Dy-tre veta. Kërkojmë edhe një herë numërimin për... abstenim.

Pra, me 82 vota për është votuar. Mjaftojnë për votimin e mocionit.

Tani, në bazë të nenit 9.1 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, e ftoj që ta udhëheqë seancën deputetja më e vjetër, Milka Vuletiq.

(Drejtimin e mbledhjes e merr deputetja Milka Vuletiq.)

KRYESUESJA: Më mirë do të na shprehim se sa shprehim, da nastavimo sa svečanom sednicom, da nastavimo gde smo ostali.

Znači, tražimo od sekretara da utvrdimo najpre kvorum.

U sali imamo prisutno 82 poslanika, što znači da imamo kvorum i da možemo početi sa radom.

Imamo sada, nastavljamo sa četvrtom tačkom, a to je:

4. Izbor Predsednika i potpredsednika Skupštine

Predlog poslaničke grupe LDK-AAK-Nisma za predsednika Skupštine bilo je za kandidata Isa Mustafu. Molim da se glasanjem izjasnimo ko je za.

Obaveštavam vas da je 65 poslanika glasalo za, što znači prisutno je bilo 83. Sad ko je protiv? Nema protiv. Ko abstenira?

Znači nije na odmet, izvinite da kažem ponovo, da je od 82, koliko je prisutno, 65 glasalo da Isa Mustafa bude predsednik Skupštine. 18 je absteniralo...

(Duartrokitje)

Hvala! Faleminderit! Sada ima reč Vjosa Osmani. Izvolite da predložite kandidata ispred grupe.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, e nderuara kryesuese!

Në emër të Grupit Parlamentar LDK-AAK-Nisma, kërkoj që të na lejohet që propozimin tonë për nënkryetar ta bëjmë në seancën e radhës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Da li “Samoopredeljenje” - “Vetëvendosje” ima članove? Izvolite!

VISAR YMERI: Faleminderit!

Nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, kandidat për nënkryetar të Kuvendit do të jetë Glauk Konjufca.

KRYESUESJA: Dragi poslanici i poslanice,

Pošto za sada LDK i PDK nemaju predlog za potpredsednika, idemo na glasanje za Glauk Konjufca. I molim vas da se izjasnite ko glasa za taj predlog?

Za predlog koji smo imali glasalo je 82 poslanika, smatramo da je i on izabran. Pitam da li Poslanička Grupa Srpska Lista ima svoga predstavnika. Izvolite!

JELENA BONTIĆ: Zahvaljujem predsedavajuća!

Poslanička Grupa Srpska Lista nema predlog kandidata za potpredsednika Skupštine i zahtevamo odobrenje da na narednoj sednici damo predlog za kandidata. Hvala!

KRYESUESJA: A sada “6+”, dali oni imaju predlog?

MAHIR YAGCILAR: Hvala, gospođo predsedavajuća!

Të nderuar deputetë,

6 deputetë nga komunitete të ndryshme, unë, Rasim Demiri, Myfera Shinik, Duda Balje dhe Kujtim Paçaku dhe Danush Ademi e kemi formuar Grupin “6+” dhe në emër të grupit me rotacion e propozojmë për periudhën e parë Duda Balje, për periudhën e dytë Myfera Shinik, për periudhën e tretë Danush Ademi, dhe Kujtim Paçaku, me rotacion. Faleminderit!

KRYESUESJA: Pitam poslanike, ko je za predlog koji je kolega istakao? Da li prihvataste takav predlog?

(Ndërhyrje e sekretarit: Ne, ne, da bude Duda!)

Oni znaju... da bude znači Duda Balje. Zatim Myfera Šinik, ko je za? Danush Ademi dhe Kujtim Paçaku.

Tu se radi o, znači... smena sa rotacijom. 80 je glasalo za. Znači da je predlog usvojen. Na kraju htela bih da pozovem Isa Mustafu, da kaže nekoliko reči. Trebalo bi! Čestitam!
(Duartrokitje)

ISA MUSTAFA: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar përfaqësues të korit diplomatik, që jeni sot së bashku këtu me ne,
Të nderuar përfaqësues të medieve,
Ju falënderoj shumë për besimin që sot ma dhatë me votën tuaj, të gjithë ju, pa marrë parasysh se si keni votuar sot, sepse unë e vlerësoj çdo votë të deputetëve dhe ju siguroj që si kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës do të punoj në interes të të gjithë deputetëve, në interes të të gjitha grupeve parlamentare, pa marrë parasysh se a janë sot të gjithë në sallë këtu, apo nuk janë, sepse konsideroj që një sjellje e tillë imja dhe juaja është në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Do të punojmë shumë për integrimin e komuniteteve tona joshumicë, prej të cilave sot edhe unë dhe nënkryetarët e Kuvendit e morën votën. Dhe, do të ju siguroj që në seancën e ardhshme të Kuvendit ne të votojmë për nënkryetarët tjerë të Kuvendit dhe po ashtu të votojmë në pako për të gjithë nënkryetarët e Kuvendit, në mënyrë që të përplotësohen kushtet, të cilat Rregullorja e Kuvendit i parasheh për zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ne do të vazhdojmë që në Kuvendin e Republikës së Kosovës të merremi me temat të cilat janë në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës, me çështjet që sigurojnë zhvillimin ekonomik, që sigurojnë punësimin, shtetin ligjor, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe po ashtu do të angazhohemi që ta përforcojmë partneritetin tonë ndërkombëtar, duke i plotësuar të gjitha nevojat e fqinjësisë së mirë, të dialogut me fqinjët, të implementimit të marrëveshjeve të cilat janë në harmoni me Kushtetutën dhe subjektivitetin e Republikës së Kosovës.

Ju uroj të gjithëve zgjedhjen sot për deputetë, në të vërtetë betimin tuaj dhe fillimin në këtë seancë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kërkoj bashkëpunim dhe përkrahje tuajën në të gjitha çështjet që ju i vlerësoni se janë në interes të përbashkët të deputetëve dhe të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit dhe urime!

KRYESUESJA: Molim vas Predsedniče, ja vas pozivam da zauzmete vaša mesta!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i zgjedhur i Kuvendit, Isa Mustafa.)

KRYETARI: Deputetë të nderuar të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Meqenëse sot nuk e përmbyllëm propozimin për të gjithë nënkryetarët e Kuvendit, në mënyrë që ta kemi të kompletuar edhe Kryesinë e Kuvendit, atëherë unë do ta shfrytëzoj të drejtën që si kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës ta thërras seancën e ardhshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ta përcaktoj rendin e ditës në harmoni me nenin 67 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në seancën e ardhshme ne do të procedojmë me kompletimin e Kryesisë së Kuvendit, përkatësisht me propozimet për nënkryetarë nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe nga Lista serbe, nga të cilat grupe parlamentare sot... në të vërtetë nga Grupi Parlamentar LDK-AAK-Nisma dhe nga Grupi Parlamentar PDK dhe Lista serbe, sepse i kemi 3 grupe parlamentare, nga të cilat do të kemi kandidatë për nënkryetarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Me kaq, ju falënderoj edhe një herë, e konsideroj të përmbyllur këtë seancë konstituive të Kuvendit dhe ju uroj shëndet dhe suksese!

* * *

E enjte, më 18 shtator 2014

Vazhdimi i mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 17 korrik 2014

Mbledhjen e drejton deputetja e Kuvendit, znj. Flora Brovina.

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë, mirëdita!

Të nderuar mysafirë,

Zoti Samuel Zhbogar, përfaqësues i BE-së,

Zonja Tracy An Jacobson, ambasadore e Shteteve të Bashkuara,

Ambasadorë, përfaqësues të zyrave diplomatike në Kosovë,

Përfaqësues të bashkësisë fetare në Kosovë,

Të nderuar mysafirë të tjerë, media, mirë se keni ardhur!

Të nderuar deputetë,

Në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, rasti KO 119/14, datë 26 gusht 2014, vazhdojmë mbledhjen konstituive të Legjislaturës V, të filluar më 17 korrik 2014.

1. Zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se në bazë të pikës c të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese për rastin KO 119/14, datë 26 gusht 2014, seanca konstituive e Kuvendit, që ka filluar më 17 korrik 2014, nuk është realizuar plotësisht, konkretisht nuk janë zgjedhur kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit. Rrjedhimisht, Kuvendi duhet ta përfundojë seancën konstituive, duke e zgjedhur kryetarin dhe nënkryetarët, në pajtim me nenin 67, pika 2 dhe në lidhje me nenin 64, pika 1 e Kushtetutës dhe me Kreun III të Rregullores së Punës, që i zbaton këto nene dhe në pajtim me këtë aktgjykim.

Andaj, në bazë të nenit 67, paragrafi 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, e ftoj përfaqësuesin e Partisë Demokratike të Kosovës, zotin Hajredin Kuçi, që ta propozojë kandidatin për kryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

HAJREDIN KUÇI: E nderuara kryesuese e Kuvendit, zonja Brovina,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Jam i nderuar që në emër të Partisë Demokratike të Kosovës ta propozoj një kandidat për kryetar të Kuvendit, i cili është për herën e pestë në këtë legjislaturë si deputet i Kuvendit të Kosovës, është i shquar si personalitet që ka kontribuar në shtetndërtimin e Kosovës, por edhe në kuptim profesional në ndërtimin e gjeneratave të tëra në drejtësi, por edhe në

fusha të tjera të vendit tonë. Po ashtu, është edhe një koleg i shquar në punën politike të vendit tonë. Ai është profesor Arsim Bajrami, për të cilin ju ftoj që ta votoni. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Kuçi!

Ju njoftoj se kryetari i Kuvendit zgjidhet me shumicë të votave të deputetëve të Kuvendit, me së paku 61 për.

Konstatoj se të pranishëm janë 116 deputetë. Para çdo votimi do ta konstatojmë praninë e deputetëve.

Tani lus deputetët që me ngritje të dorës të deklarojnë për kandidatin e propozuar nga Partia Demokratike e Kosovës. Kush është për? Numërojnë votat! Ju lus ta ngrini dorën pak më lart që ta kenë më lehtë t'i numërojnë votat. Kush është kundër? Faleminderit! Kush abstenon? Ju faleminderit!

Rezultati është ky:

Për janë 44,
Kundër janë 61,
Abstenojnë 11.

Konstatoj se kandidati nuk i mori votat e mjaftueshme për t'u shpallur kryetar i Kuvendit.

Andaj, për shkak të votave të pamjaftueshme të kandidatit të Partisë Demokratike, e cila e ka të drejtën e kandidimit të kryetarit të Kuvendit, jam e detyruar ta ndërpres këtë seancë. Deputetët do të lajmërohen me shkrim për vazhdimin e seancës konstituive gjatë javës së ardhshme.

E lus Sekretarinë që t'i përmbahet udhëzimit në mbështetje të aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese për ndërprerjen e seancës nga unë. Faleminderit! Seanca ndërpritet, ju lajmërojmë për vazhdimin.

* * *

E hënë, më 8 dhjetor 2014

Vazhdimi i mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 17 korrik dhe e vazhduar më 18 shtator 2014

Mbledhjen e drejton deputetja e Kuvendit, znj. Flora Brovina.

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë,

Të nderuar mysafirë,

Zonja Ulrike Lunaçek, nënkryetare e Parlamentit Evropian,

Gjeneralmajor Francesco Paolo Figliuolo, komandant i KFOR-it,

Zonja Tracy Ann Jacobson, ambasadore e Shteteve të Bashkuara,

Ambasadorë dhe përfaqësues të zyrave diplomatike në Kosovë,

Përfaqësues të bashkësive fetare në Kosovë,

Të nderuar të pranishëm dhe mysafirë,

Të nderuara media,

Mirë se erdhët në vazhdimin e mbledhjes konstituive të Legjislaturës V. Në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO 119/14, data 26 gusht 2014, vazhdojmë me mbledhjen konstituive të Legjislaturës së Pestë, me pikën e fundit që na ka mbetur, e që është:

1. Zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit

Të nderuar deputetë,

Në bazë të nenit 67, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, e ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës që ta propozojë kandidatin për kryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Urdhëroni, zoti Hajredin Kuçi!

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

E nderuara kryesuese e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Zonja Lunaçek,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, duke e shfrytëzuar të drejtën tonë kushtetuese që buron nga zgjedhjet e 8 qershorit të këtij viti, të propozoj kandidatin për kryetar të Kuvendit.

Partia e Demokratike e Kosovës e propozon kandidatin për kryetar të Kuvendit zotin Kadri Veselin, i cili njihet si themelues i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, një njeri i cili ka vepruar për një kohë të gjatë në shërbim të vendit dhe njeri i cili e ka edhe përgatitjen adekuate akademike - në përfundim të doktoraturës në Universitetin e Lubjanës. Besojmë që kandidatura e tij do të ndikojë në mirëvajtjen e punës së Kuvendit.

Për ta shfrytëzuar kohën në mënyrë racionale, e propozoj edhe kandidatin për nënkryetar të Kuvendit - zotin Xhavit Haliti, i cili është deputet i zgjedhur për Legjislaturën e Pestë, njëkohësisht edhe ky themelues i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, njeri të cilin e njohim të gjithë ne për aktivitetin e tij, edhe politik, edhe kombëtar dhe të tjera.

Ju ftoj që t'i miratoni këto dy kandidatura, veç e veç. Faleminderit!

KRYESUESJA: Kryetari zgjidhet me shumicë votash, d.m.th. për duhet të jenë së paku 61 vota. Sekretaria konstaton se në seancë janë të pranishëm 119 deputetë, pra e kemi kuorumin. Tani vazhdojmë me votimin.

Votojmë me ngritje dore. Kush është për? Ju lutem, numërojeni votat!

Konstatohet se për janë 71 vota.

Kush është kundër? Numërojeni votat! 42 janë kundër.

Abstenime? Një abstenim.

Konstatohet se me 71 vota, kryetar i Kuvendit të Kosovës u zgjodh zoti Kadri Veseli.

(Duartrokitje)

Vazhdojmë me zgjidhjen e nënkryetarëve të Kuvendit:

Partia Demokratike tanimë e ka dhënë propozimin, z. Xhavit Haliti.

Vazhdojmë me Lidhjen Demokratike të Kosovës, përfaqësuesi e jep propozimin.

ISMET BEQIRI: Ne për nënkryetar të Kuvendit e propozojmë akademik Sabri Hamitin. Faleminderit!

KRYESUESJA: Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesuese!

Konfirmim më të madh se Kosova s'ka as demokraci, as republikë, e as drejtësi nuk ka mundur të ketë sesa ky instalim i kreut të nëntokës në krye të organit më të rëndësishëm legjislativ dhe më të rëndësishëm politik të vendit, në krye të Kuvendit, edhe atë edhe me votat e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Lëvizja “Vetëvendosje” për nënkryetar të Kuvendit e propozon deputetin Glauk Konjufca.

KRYESUESJA: Faleminderit!

Tani kemi propozime për tre nënkryetarë dhe e konstatojmë praninë. Është e njëjta prani, pra 119 deputetë të pranishëm. Votojmë si më parë.

Kush është për, me ngritje dore. Numërojeni votat!

Kush është kundër? Abstenim? Numërojeni abstenimet!

Atëherë konstatoj se për janë 98 deputetë, 2 kundër dhe 15 abstenojnë. Konstatoj se nënkryetarë të Kuvendit u zgjodhën: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Glauk Konjufca. Urime!

(Duartrokitje)

Në pajtim me nenin 67, paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, deputetët që mbajnë vendet e garantuara për komunitetin serb e propozojnë një kandidat për nënkryetar të Kuvendit, dhe deputetët që mbajnë vendet e garantuara për komunitetet tjera që nuk janë shumicë e propozojnë një kandidat për nënkryetar të Kuvendit.

E ftoj përfaqësuesin e deputetëve të komunitetit serb që ta japë kandidaturën e tyre.

BOJAN MITIĆ: ... narodni poslanici,
Ispred Srpske liste za podpredsednika Skupštine predlažemo Jasminu Živković.

KRYESUESJA: E ftoj përfaqësuesin e deputetëve të komuniteteve tjera që ta japë propozimin e tyre.

MAHIR YAGCILAR: Saygıdeğer Başkanlık Divanı ve Saygıdeğer milletvekilleri,
E nderuara zonja kryesuese,
Të nderuar deputetë,
Në bazë të nenit 67, paragrafit 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ne 6 deputetët nga radhët e komuniteteve propozojmë që Kryesia ose nënkryetari nga radhët e komuniteteve të bëhet në mënyrë me rotacion, në periudhën e parë prej 14 muajsh zonja Duda Balje, përfaqësues i KDTP-së i komunitetit turk pastaj 14 muaj, Danush Ademi 7 muaj dhe Kujtim Paçaku gjithashtu 7 muaj. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Tani votojmë edhe për këta dy kandidatë. Konstatoj se të pranishëm janë 119 deputetë.

Votojmë! Numërojeni votat! Kush është për? Kush është kundër? Ka abstenime?

Konstatoj se me 75 vota për, 19 kundër dhe 20 abstenime, zgjidhen nënkryetarët e komuniteteve: Jasmina Zhivković dhe Duda Balje.

E lus me këtë rast kryetarin e sapozgjedhur të Kuvendit të Kosovës që ta zërë vendin e tij.

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i zgjedhur i Kuvendit të Kosovës, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar të zgjedhur të popullit!
I falënderoj shumë të gjithë ata që nuk më kanë votuar, ata të cilët kanë abstenuar dhe ata të cilët kanë votuar që unë sot të jem këtu i nderuar si kryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës. Na ndihmoftë Zoti të gjithëve bashkërisht!

(Duartrokitje)

Kisha dëshiruar paraprakisht, duke qenë i nderuar të jem këtu para jush, që edhe nënkryetarët, në qoftë se ka mundësi, të dalin këtu së bashku me ne. Të njëjtën kohë, në shenjë respekti për ju, unë do të dëshiroja ta mbaja një fjalim të rastit. Do të dal atje para jush. Në të njëjtën kohë e ftoj nënkryetarin që ta marrë drejtimin e seancës. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i zgjedhur i Kuvendit të Kosovës, z. Xhavit Haliti.

KRYETARI: Të nderuar deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës,
E nderuara ambasadore e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zonja Tracy Ann Jacobson,
E nderuara nënkryetare e Parlamentit Evropian, zonja Lunaçek,
Të nderuar shkëlqesi, ambasadorë të vendeve partnere të Republikës së Kosovës,
Të dashur qytetarë të Republikës,
Më lejoni ta filloj fjalimin tim si kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës duke shprehur respektin më të thellë për gjithçka që kemi arritur bashkërisht që nga momenti i lirisë sonë.

Jemi këtu të gjithë ne sot para qytetarëve tanë, duke i falënderuar së pari familjet e shenjta, mbi supet e të cilave është ngritur liria jonë, familjet e dëshmorëve, si themelet e lirisë dhe pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Për të gjithë ne këtu dhe të gjithë qytetarët e kësaj republike, Adem Jashari është inspirim dhe sinonim sublim i vlerave më të shenjta liridashëse. Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte kapitulli i fundit, por më i rëndi dhe më i rëndësishmi i betejës sonë shekullore për liri dhe shtet. E shfrytëzoj rastin ta përmend edhe rezistencën paqësore dhe veprën e presidentit të ndjerë Ibrahim Rugova që arriti t'i mobilizojë të gjitha shtresat e shoqërisë kosovare me kërkesën për liri dhe pavarësi të vendit tonë.

Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,
Ky Kuvend do të jetë një vend i debateve gjithëpërfshirëse dhe i kompromiseve, e jo i metodave dhe gjuhës përjashtuese.

Unë që nga sot, si kryetari juaj i zgjedhur, me devotshmëri do ta respektoj fjalën tuaj si deputetë të nderuar, të opozitës dhe pozitës. Do të angazhohem që debatet tona pozitë-opozitë të jenë mbi politikat ditore, mbi mosmarrëveshjet personale, por në angazhimin në interes të vendit.

U ovom trenutku, veoma je važno potencirati da je ovo Skupština svih zajednica Republike Kosova.

Meni je izuzetna čast, ali i velika odgovornost, da budem predsednik ove Skupštine, gde će prvi put biti predstavljeni svi građani Republike Kosova, svih delova i svih zajednica Kosova. Čestitam vam svima!

Ky do të jetë një fillim i ri, një fazë e re dhe një mision i ri, por kemi edhe kontinuitet të pashlyeshëm, kontinuitet i cili qëndron në vlerat tona që kemi përqaftuar kur kemi rezistuar dhe luftuar për liri dhe për ta ndërtuar Kosovën e pavarur, si pjesë e vlerave euroatlantike, vlera të cilat janë betonuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ku gjinia, raca, gjuha, feja e dallimet seksuale nuk janë bazë e diskriminimit - vlera civilizuese perëndimore, që ruhen e promovohen vazhdimisht nga partnerët tanë strategjikë - Bashkimi Evropian dhe veçanërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Këto vlera bazohen në shtetin e së drejtës, në demokracinë tonë parlamentare të shoqërisë sonë që bashkërisht të punojmë drejt së mirës së vendit tonë.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në pika të shkurtra të shpalos synimet tona të përbashkëta parlamentare: Do të punojmë me përkushtim që të aprovojmë ligje të cilat e krijojnë një ambient për zhvillimin e vendit tonë, ligje të cilat e përshpejtojnë rrugën tonë drejt integriteteve euroatlantike dhe ndërtimin e shtetit të së drejtës, ligje dhe vendime që do të sjellin vende të reja pune, do të sjellin një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe që premtojnë mundësi e shpresë për çdo qytetar të Republikës sonë.

Ky do të jetë Parlamenti që do të ratifikojë konventa, që ne bashkërisht të jemi anëtar i Këshillit të Evropës, si dhe i Partneritetit për Paqe me NATO-n. Pra, ky do të jetë Kuvendi që do t'i themelojë Forcat e Armatosura të Kosovës.

Fuqizimi i partneritetit tonë ndërkombëtar dhe përmbushja e obligimeve tona shtetërore, si Marrëveshja historike e Brukselit, luftimi i ekstremizmave, si dhe obligimet tjera si vlerë e partneritetit tonë të zhvilluar tradicional ndërkombëtar.

Ne duhet të gjithë bashkërisht të angazhohemi fuqimisht që ta vazhdojmë traditën si një vend tolerant dhe një shembull global i bashkëjetesës ndërfetare dhe ndëretnike. Kjo është një pasuri e Kosovës, të cilën ne duhet ta respektojmë dhe kultivojmë pa dallim partiak dhe ta ruajmë si vlerë kombëtare.

Do të punojmë fuqimisht që pakicat e Kosovës të mos jenë asnjëherë të rrezikuara nga shumica. Ne posaçërisht si shqiptarë kemi parë dhe kemi përjetuar se çfarë do të thotë të jesh i shtypur dhe të ndihesh inferior si qytetar në vendin tënd.

Si kryetar i Kuvendit, jam i vendosur që në Kosovë të mos krijohet kurrë më një klimë e tillë. Që qytetarët tanë të mos diskriminohen mbi bazën e etnisë, apo t'i nënshtrohen ndonjë gjuhe të urrejtjes ndëretnike, apo gjuhës së urrejtjes së shumicës.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni ta përfundoj këtë fjalim timin me një premtim se puna jonë e përbashkët për ta ndërtuar një Kosovë demokratike do të pasqyrohet në përkushtimin e secilit prej nesh në këtë Kuvend dhe qindra-mijëra njerëzve anekënd vendit tonë që na përcjellin sot aktualisht, që qysh nga dita e nesërme të jemi edhe më të bashkuar, të jemi edhe më solidarë, duke trasuar mbi rrugën që e kaluan shumë gjenerata deputetësh para nesh.

Me shpresë në ndihmën e Zotit, dhe me dashuri të patundur ndaj vendit tonë, Ju falënderoj të gjithëve për këtë vëmendje të veçantë. Suksese të përbashkëta!

(Duartrokitje)

Faleminderit! Kuvendin e konsiderojmë të konstituuar edhe formalisht. Në të njëjtën kohë, kisha dëshiruar që në orën 13:00 ta kemi një takim me nënkryetarët - me Kryesinë e Parlamentit të Kosovës - dhe nga këtu mbyllet seanca deri në njoftimin e ardhshëm. Faleminderit! Suksese!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*